

PROJEKT

MARRËVESHJE E BASHKIMIT TË SHOQËRIVE NËPËRMJET PËRTHITHJES

SHOQËRIA "SAFE SECURITY ALBANIA"SH.P.K.

Forma Juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Selia: TIRANE Rruga Bajram Curri, Zona Kadastrale Nr. 8160, Pasuria me Numer 2/276-D10, Vol. 39, Faqe 107, Godina ETC.
Kapitali Themeltar: 190,593,000.00 LEKE
Pjese e kapitalit: 100%
ORTAKET: CONCORD INVESTMENT zoteron 100% te kapitalit.
NIPT J72207013A
Administrator: Z. Ervin Vaso

SHOQËRIA PËRTHITHËSE

DHE

SHOQËRIA "GLOB 06"SH.P.K.

Forma Juridike: Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
Selia: TIRANE Njesia Nr. 2, Bulevardi Bajram Curri, Qendra Tregtare ETC.
Kapitali Themeltar: 1,000,000.00 LEKE
Pjese e kapitalit: 100%
Ortaku: Shoqëria "SAFE SECURITY ALBANIA" shpk
NIPT K61719012T
Administrator: Znj. Enkela Gjokollari

SHOQËRIA E PËRTHITHUR

Bien dakort për sa vijon:

1. OBJEKTI I MARRËVESHJES

Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë së Perthithur "GLOB 06" sh.p.k nga shoqëria Perthithese "SAFE SECURITY ALBANIA" shpk. Në këtë operacion bashkimi shoqëria "SAFE SECURITY ALBANIA" shpk do të jetë shoqëria përthithëse ndërsa shoqëria "GLOB 06" sh.p.k do të jetë shoqëria e përthithur.

Objekti i veprimtarisë për shoqërinë Perthithese "SAFE SECURITY ALBANIA" shpk është: Shoqëria ka si objekt të saj administrimin dhe kryerjen e shërbimeve për sipërfaqet

e perbashketa/ne bashkepronesi per qendra biznesi, qendra tregtare, komplekse industriale dhe rezidenca banimi. Keshillim per realizimin dhe zhvillimin e marketingut te qendrave tregtare dhe rezidencave te banimit. Menaxhimi i qendrave tregtare, industriale, te biznesit dhe komplekseve te banimit, me te drejten e qiradhenies se ketyre ambienteve dhe administrimit te siperfaqeve te perbashketa/ne bashkepronesi, ne rolin e pronarit dhe/ose perfaqesuesit/te autorizuarit te pronarit/pronareve per kryerjen e ketyre veprimeve etj. Ruajtja e objekteve dhe institucioneve publike dhe private, sigurimi fizik, mbrojtja e jetes dhe shendetit te shtetesave vendas dhe te huaj, instalimi dhe perdorimi i sinjalistikes te radioalarmit dhe pajisjeve te tjera te vezhgimit. Projektimi dhe instalimi i kontrollit te aksesit dhe te sigurise se larte, integrimi i sistemeve. Furnizimi dhe instalimi i kasafortave cavoux, siguria e kutive te depozitave, terminale POS, ATM dhe pajisja bankare ne pergjithesi. Prodhimi, mirembajtja dhe tregtimi i pajisjeve dhe lendeve te shuarjes se zjarrit dhe shpetimit. Konsulenca dhe analize te sigurise. Projektimi, furnizimi, instalimi dhe mirembajtja e sistemeve te inteligjences. Projektimi, zbatimi, mirembajtja dhe monitorimi i sistemeve te shuarjes se zjarrit. Projektimi dhe instalimi i pajisjeve dhe impjanteve elektrike e civile. Furnizimi, instalimi, mirembajtja e pajisjeve elektronike per perdorim detar. Furnizimi, instalimi dhe mirembajtja e pajisjeve te telekomunikacionit dhe radio nderlidhjes/import eksport me shumice dhe pakice, e materialeve te teknologjise elektrike dhe elektronike, pajisje per navigacion. Sherbimi i ruajtjes, transportit dhe shoqerimit te vlerave monetare e sendeve te çmuara. Sigurimi fizik i objekteve shteterore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike. Import-eksport dhe shperndarje te shtypit shqiptar, import-eksport dhe shperndarje e shtypit dhe e librave te huaj, perfaqesimi dhe shperndarja e mallrave, ndermarrja e botimeve te çdo lloji dhe ne ç'faredo gjuhe, ndermarrja e aktiviteteve te shtypshkrimit dhe cdo lloji aktiviteti te lidhur me kete si dhe operimi i magazinave te shtypit. Shitje artikuj te ndryshem suvenire, kancelari, vepra arti, aksesore te ndryshem per libra dhe kompjutera, cigare, pije suvenir, lodra cd dhe dvd etj te ngjashme, shitjet on-line.

Objekti i veprimtarisë për shoqërinë e Perthithur “GLOB 06”shpk eshte: Import-eksport, tregtim me shumice e pakice te konfeksioneve te ndryshme te te gjitha llojeve si veshmbathje, aksesore te ndryshem, ora, bizhuteri, optike etj..

Të dyja shoqëritë sa më lart, pra Shoqëria “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k dhe shoqëria “**GLOB 06**”shpk, hartojnë këtë projekt marrëveshje nëpërmjet përfaqësuesve të tyre ligjor, bazuar specifikisht në Nenet 215, 216, 225 të Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit”.

Duke qenë se Shoqëria Perthithese “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k është 100% Ortak i shoqërisë që do të përthithet Shoqëria “**GLOB 06**” sh.p.k, ky bashkim me përthithje do të realizohet bazuar në këtë Marrëveshje.

2. MOTIVET DHE QËLLIMI I BASHKIMIT

Bashkimi nëpërmjet përthithjes i shoqërisë “**GLOB 06**” sh.p.k nga Shoqëria “**SAFE SECURITY ALBANIA**”sh.p.k bëhet në kuadrin e riorganizimit të aktivitetit tregtar, përfshirë aktivitetin financiar dhe tregtar të Shoqërisë Perthithese “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k.

OBJEKTI i veprimtarisë së shoqërisë Perthithese “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k do të përfshijë dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë se Perthithur “**GLOB 06**” sh.p.k.

3. AKTIVET DHE PASIVET

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi shoqëria e Perthithur “**GLOB 06**” sh.p.k do t’i transferojë shoqërisë Perthithese “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k tërësinë e elementeve të aktivitetit dhe pasivit sipas bilancit kontabël të vitit që përfundoi më 31.12.2021, duke marrë në konsideratë edhe çdo ndryshim të ndodhur deri në momentin e përthithjes që është data 31.12.2021.

Shoqëria Përthithëse “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k dhe Shoqëria e Përthithur “**GLOB 06**” sh.p.k ka hartuar pasqyrat financiare të muajit që përfundon më 31.12.2021, të cilat paraqesin vlerën kontabël të aseteve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur më 31.12.2021, dhe do t’i bashkangjiten bilancit të shoqërisë përthithëse “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k.

Të gjitha marrëdhëniet kontraktuale të lidhura nga shoqëria e përthithur “**GLOB 06**” sh.p.k dhe që janë në fuqi në datën e përthithjes, transferohen te shoqëria përthithëse “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k., e cila merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga këto marrëdhënie kontraktuale.

4. DATA E PËRTHITHJES

Në aspektin juridik, data e përthithjes do të konsiderohet data e pranimit Zyrtar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) dhe e lëshimit prej saj të Çertifikatës së Çregjistrimit të Shoqërisë së Përthithur “**GLOB 06**” sh.p.k. Efektet financiare dhe të kontabilitetit, përfshirë deklaratimet për Zyrën e Punës dhe për Organet Tatimore do të zbatohen nga data 01.01.2022. Të gjitha operacionet e veprimtarisë pas datës 01.01.2022, do të kryhen nga shoqëria përthithëse “**SAFE SECURITY ALBANIA**”sh.p.k. Pas kësaj date çdo e drejtë apo detyrim, çdo veprim financiar, ekonomik apo administrativ do të kryhet nga Kompania Perthithese “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k dhe do të pasqyrohet në kontabilitet nga shoqëria përthithëse “**SAFE SECURITY ALBANIA**”sh.p.k.

5. TË DREJTAT DHE DETYRIMET ME PALËT E TRETA DHE ME INSTITUCIONET SHTETËRORE

Pas datës së përthithjes, Shoqëria “**SAFE SECURITY ALBANIA**” sh.p.k merr çdo të drejtë e detyrim që ka patur shoqëria e përthithur “**GLOB 06**” sh.p.k. në marrëdhëniet me të gjithë personat fizikë apo juridikë si dhe institucionet shtetërore, si organet tatimore vendore dhe qendrore, përfshirë Qendrën Kombëtare të Biznesit, Drejtorinë e Regjistrimit të Automjeteve, Zyrën e Punës, etj.

Shoqëria Perthithese "SAFE SECURITY ALBANIA" sh.p.k do të jetë përgjegjëse për ndjekjen e të gjitha procedurave dhe përgjegjësiave financiare, juridike dhe administrative me organet tatimore qendrore dhe vendore deri në çregjistrimin prej tyre të shoqërisë së Perthithur "GLOB 06" sh.p.k.

6. KAPITALI THEMELTAR

Duke qenë se Kompania Perthithese "SAFE SECURITY ALBANIA" sh.p.k është 100% ortak i shoqërisë që do të përthithet Shoqëria "GLOB 06" sh.p.k., ky bashkim me përthithje nuk do të sjell ndryshim në Kapitalin Themeltar të shoqërisë përthithëse.

7. TË DREJTA DHE AVANTAZHE TË VEÇANTA

Ky bashkim me përthithje nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë për ortakët, duke qenë se shoqëria përthithëse "SAFE SECURITY ALBANIA" sh.p.k është 100% Ortak e shoqërisë së përthithur "GLOB 06" sh.p.k.

8. MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

Punëmarrësit e shoqërisë së përthithur "GLOB 06" sh.p.k. do të transferohen në shoqërinë përthithëse "SAFE SECURITY ALBANIA" sh.p.k, nëpërmjet nënshkrimit të kontratave të reja të punësimit.

Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, shoqëria e Perthithur "GLOB 06" sh.p.k. dhe shoqëria Perthithese "SAFE SECURITY ALBANIA" sh.p.k, do të deklarojnë në organet tatimore respektive dhe në Zyrën e Punës largimin nga puna të punonjësve të Shoqërisë së Perthithur "GLOB 06" sh.p.k. dhe marrjen e tyre në punë nga Shoqëria Perthithese "SAFE SECURITY ALBANIA" sh.p.k.

Shoqëria Perthithese
"SAFE SECURITY ALBANIA" shpk

Administratori:

Ervin Vero



Shoqëria e Perthithur
"GLOB 06" sh.p.k

Administratori

Edela Grollo



Hartuar në Tiranë më datë 07.10.2022